

VENDIM
Nr.501, datë 9.6.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1252, DATË 10.9.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË TENDERIT
PUBLIK, PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 69 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në “Rregullat e zhvillimit të tenderit publik, për dhënie e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1252, datë 10.9.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Në pikën 2.1 të kreut I, fjalët “...kryhet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit...” zëvendësohen me “...kryhet nga ministri përgjegjës për fushën e komunikimeve elektronike...”.

b) Në kreun III bëhen këto ndryshime:

i) Në pikën 17.1, fjalët “...përfaqësues të MPPT dhe METE, kur është e nevojshme...”, zëvendësohen me “...përfaqësues të ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë...”.

ii) Pikat 19.4, 21 dhe 21.1 ndryshohen si më poshtë vijon:

“19.4. Kur ofertuesi fitues nuk arrin të nënshkruajë autorizimin individual, AKEP-ja bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe përzgjedh ofertuesin e radhës në listën e ofertesve që kanë mbetur. Kjo nuk cenon të drejtën e AKEP-së, sipas pikës 9.1, të këtij kreu, për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e tenderit. Njoftimi sipas pikës 19.1, të këtij kreu, i dërgohet ofertuesit, oferta e të cilit është përzgjedhur sipas kësaj pike.”.

“21. ...Ndërprerja e procesit të përzgjedhjes së fituesit

21.1 Proces i përzgjedhjes së fituesit, në vijim të procedurës së tenderit, vazhdon edhe nëse numri i ofertave të vlefshme do të rezultojë i barabartë ose më i vogël se numri i të drejtave të përdorimit të frekuencave që tenderohen, duke respektuar rregullat e konkurrencës dhe objektivat e politikës për zhvillimin e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ndërprerja e procesit të përzgjedhjes së fituesit zbatohet vetëm në rast se, në përfundim të vlerësimit të ofertave, nuk rezulton asnjë ofertë e vlefshme.”.

c) Në kreun IV bëhen këto ndryshime:

i) Në pikën 1.1, fjalët “...dhe më pas nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit...” zëvendësohen me “...dhe më pas, nga ministri përgjegjës për fushën e komunikimeve elektronike...”.

ii) Në pikën 1.5, fjalët “me shkrim pranë ministrit të MPPT...” zëvendësohen me “...me shkrim pranë ministrit përgjegjës për fushën e komunikimeve elektronike...”.

2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha